VENDIM
Nr. 623, datë 18.9.2019

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE EOLIKE DHE TË VEPRAVE NDIHMËSE, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE TOPOJË, QARKU FIER, NGA SHOQËRIA "WINDSBAB", SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe të veprave ndihmëse, në njësinë administrative Topojë, Qarku Fier, nga shoqëria "WINDSBAB", sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: shoqëria "WINDSBAB", sh.p.k.;

b) Numrin e identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: L82810402A

c) Tipi centralit: eolik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 3 MW;

d) Numri i njësive gjeneruese të burimit gjenerues të energjisë dhe kapaciteti i tyre në MW: 1 (një) turbinë me kapacitet 3 MW;

dh) Afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 24 muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;

e) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Territori në zonën Topojë, Qarku Fier;

ë) Afati i miratimit të ndërtimit: 48 muaj nga hyrja në fuqi e këtij miratimi;

f) Koordinatat e tokës janë sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

g) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucione të tjera të autorizuara prej saj, kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore, gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

gj) Shoqëria "WINDSBAB", sh.p.k. ka detyrimin që:

i. të paraqesë, periodikisht, (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, informacion mbi ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë "WINDSBAB", sh.p.k. dhe ministrisë përgjegjëse. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë sasinë e energjisë elektrike, në masën jo më të vogël se 2% të sasisë vjetore të prodhimit ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, këto të ardhura derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1

Koordinatat e tokës

Kontratë qiraje toke pasuri shtetërore nr. 1684 rep, nr. 1020 kol, datë 18.6.2015 ndërmjet Bashkisë Fier dhe shoqërisë "Albanian General Electricity" sh.a. Qiradhënësi është pronar i një pasurie të paluajtshme toke pa frut, me sipërfaqe të përgjithshme 144,000 m^2, e ndodhur në adresën Fier, Topojë, e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. 66, datë 11.6.2015, me numër pasurie 55, ndodhur në zonën kadastrale 3358, me kufizimet e pasurisë veri 168, jug 176, lindje 176, perëndim 175.

Akt marrëveshje nr. 2812 prot, datë 28.3.2019 "Për dhënien e të drejtës shoqërisë 'Albanian General Electricity' sh.a, të përdorë sipërfaqen e tokës së dhënë me qira nga Komuna Topojë, me datë 18.6.2015, ose pjesë të saj për implementimin e parqeve eolike (të erës) deri në 3 MW secila (në total 6 MW), në bashkëpunim me shoqëritë: "SONNE" sh.p.k., "WINDSBAB" sh.p.k. dhe "SEMAN SUNPOWER" sh.p.k.

Koordinatat e parkut eolik:

X	Y
4515875.9276	4364339.1132
4515796.1127	4364498.0433
4515877.5414	4364539.6274
4515957.4466	4364380.6230